



---

—  
—  
—  
—  
—

**FEDERATA E BASKETBOLLIT E KOSOVËS**  
**BASKETBALL FEDERATION OF KOSOVA**  
**KOŠARKAŠKA FEDERACIJA KOSOVA**

---

*[www.basketbolli.com](http://www.basketbolli.com); [www.fbk-ks.com](http://www.fbk-ks.com) ; email: [info@fbk-ks.com](mailto:info@fbk-ks.com); [federata@fbk-ks.com](mailto:federata@fbk-ks.com)*

## **RREGULLORJA PËR KALIMIN DHE REGJISTRIMIN E LOJTARËVE**

Prishtinë, shtator 2007

Kuvendi i Federatës së Basketbollit të Kosovës në bazë të nenit 21,alineja 3 të Statutit të FBK-ës në mbledhjen e mbajtur me 08.09.2007 aprovoi këtë:

## RREGULLORE PËR KALIMIN DHE REGJISTRIMIN E LOJTARËVE NË FEDERATËN E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

### Neni 1

Me këtë rregullore, në përputhje me Statutin e FBK-ës dhe Rregullat e FIBA, përcaktohen parimet themelore të çështjeve statusore të lojtarëve, kontratat, regjistrimet dhe kalimet e lojtarëve prej klubit në klub, e posaçërisht:

- Kompetenca e organit për regjistrimin e lojtarëve,
- Regjistrimi I basketbollistëve dhe basketbollisteve (në tekstin e mëtejme lojtari) për klubin e caktuar,
- Afatet kalimtare gjatë një edicioni garues,
- Kalimet e lojtarëve prej klubit në klub,
- Statusi I lojtarit amator dhe lojtarit profesionist,
- E drejta e licencimit dhe e lojës,
- Kontratat në mes të klubit dhe lojtarit,
- E drejta e paraqitjes së lojtarëve të huaj në klubet Kosovare,
- E drejta e paraqitjes së lojtarëve Kosovarë në klubet e huaja dhe kthimi i tyre në klubet vendore,
- Huazimi dhe regjistrimi i dyfishtë i lojtarëve.

### Neni 2.

Lojtari me vullnetin e lire zgjedh klubin në të cilin dëshiron të regjistrohet. Vullnetin e vet lojtari e shpreh me nënshkrimin e fletëregjistrimit. Formën dhe përmbajtjen e fletëregjistrimit e përcakton Sekretari i FBK-ës.

Për lojtarët më të rinj se 18 vjet fletëregjistrimin e nënshkruan edhe prindi ose kujdestari (në përputhje me rregullat e të Drejtës familjare)

### Neni 3.

Lojtari i cili e ka nënshkruar fletëregjistrimin për një klub, nuk mund që të tërheq nënshkrimin e tij nga ky dokument.

Nënshkrimi i fletëregjistrimit e obligon lojtarin, në afatin e pare kalimtar vijues dhe afatin i cili është në rrjedh e sipër.

Lojtari i cili nënshkruan fletëregjistrimin për dy apo më shumë klube, do të ndëshkohet me 1.000 Euro dhe do të mbetet anëtar i klubit të mëparshëm.

Kërkesa për regjistrimin e pare mundë të paraqitet gjatë tërë vitit. Lojtari i tillë regjistrohet edhe jashtë afateve kalimtare.

### Neni 4.

Regjistrimin e lojtarëve e bënë Komisioni për regjistrim. Komisioni për regjistrim i regjistron lojtarët gjatë afatit kalimtarë.

Regjistrimin e lojtarëve të huaj dhe lojtarëve të cilët për here të pare regjistrohen në FBK e bënë Sekretari i FBK-ës, ose personi tjetër i autorizuar nga bordi i FBK-ës.

#### Neni 5.

Në vendimet e Komisionit për regjistrimin e lojtarëve është lejuar ankesa, në afat prej 3 – ditëve prej ditës, datës së marrjes së vendimit për regjistrimin apo mosregjistrimin e lojtarëve.

Ankesa i parashtrohet Komisionit arbitrar të FBK-ës . K.A. duhet të marr vendim në lidhje me ankesën në afat prej 3 ditëve, prej ditës së parashtrimit të ankesës.

### -PROCEDURA E REGJISTRIMIT-

#### Neni 6.

Klubi i cili dëshiron ta regjistroj lojtarin, duhet të paraqesë:

- a) Për regjistrimin e pare:
  - Certifikatën e lindjes,
  - Fletëregjistrimin e plotësuar,
  - Dy fotografi jo më të vjetra se 6 muaj
  - Për lojtarët të cilët nuk janë të lindur në Kosovë, Dokumenti i identifikimit i organit kompetent
- b) Për regjistrimin e lojtarëve të cilët kalojnë prej klubit në klub:
  - Fletëregjistrimin e lojtarit në formularin e përcaktuar,
  - Dy fotografi jo më të vjetra se 6 muaj dhe një të njëzën prej dokumenteve nga pika a e këtij neni
  - Dëshmia se është paguar dëmshpërblimi, për lojtarët për të cilët duhet të paguhet dëmshpërblimi në bazë të kësaj rregulloreje,
  - Kopjen e kontratës, të cilës i ka skaduar afati
  - Vendimi për shkëputje të kontratës, nga ana e komisionit për regjistrim ose Komisionit Arbitrar (në tekstin e mëtejshëm K.A.)
  - Vendimi për shkëputje të kontratës me marrëveshje dhe
  - Dëshmimi që klubi nuk ka kërkuar licencimin e lojtarit për edicionin e fundit garues, ose dëshmi që klubi ka kërkuar çregjistrimin e lojtarit.
- c) Regjistrimi i dyfishtë i lojtarëve
  - Lojtarët në moshën 20 vjeçare(viti kalendarik) e më të rinj, kanë të drejtën e licencimit të dyfishtë
  - Lojtari i licencuar në këtë mënyrë ka të drejtë që për klubin amë të luaj për të gjitha kategoritë, ndërsa për klubin në të cilin regjistrohet ka të drejtë të luaj vetëm për ekipin e seniorëve.

Lojtarët e regjistruar në këtë mënyrë duhet të paraqesin:

- Formularin përkatës dhe
- Dy fotografi jo më të vjetra se 6 muaj.

- d) Për huazim.
- Fletëregjistrimi (formulari përkatës)
  - Kontrata në mes të klubeve për huazim
  - Fotografinë jo më të vjetër se 6 muaj.

Për të gjithë lojtarët duhet të bashkëngjitet edhe dëshmia për pagesën e taksës së rregullt dhe asaj shtesë (në rastet e parapara me vendim të Bordit për regjistrim në afate të jashtëzakonshme).

Për lojtarët të cilët kalojnë prej klubit në klub duhet të paguhet taksa, në lartësi prej 50 € në ditën e paraqitjes së kërkesës për ndërrimin e klubit.

Nëse kërkesa për regjistrim nuk është e kompletuar, organi kompetent për regjistrim do të i lë në dispozicion klubit dhe lojtarit 3 ditë afat për kompletimin e dokumentacionit.

Afati fillon të rrjedh menjëherë pas përfundimit të afatit kalimtar.

#### -ÇREGJISTRIMI I LOJTARIT –

##### **Neni 7.**

Çregjistrimin e lojtarit, mundë ta bëjë klubi i cili me lojtarin:

- Nuk ka kontratë të nënshkruar,
- I ka skaduar kontrata,
- Ka shkëputur kontratën me marrëveshje.

Klubi mund ta çregjistroj lojtarin edhe nëse K.A. i FBK-ës me vendim shkëput kontratën në mes të klubit dhe lojtarit.

Kërkesa për çregjistrim të lojtarit paraqitet në formularin e posaçëm të përcaktuar nga sekretari i FBK-ës.

Çregjistrimi i lojtarëve bëhet në afatet kalimtare, ose ditën e licencimit të lojtarëve për edicionin përkatës garues.

Lojtari konsiderohet i çregjistruar nëse Klubi i tij nuk paraqitet për gara ose tërhiqet nga garat e filluara.,nëse klubi nuk i pazhvilluar 50 % të ndeshjeve të Ligës.

#### -KALIMI I LOJTARËVE-

##### **Neni 8.**

Lojtari mundë të ndërroj klubin vetëm gjatë afateve kalimtare të caktuara nga bordi i FBK-ës,afati i rregullt(veror) dhe minafati (dimëror). Në afatin dimëror kalimtar lojtarët, mundë të ndërrojnë klubin vetëm nëse lojtarit i ka skaduar kontrata, ose me pëlqimin e klubit. Më pëlqimin e klubit lojtari ka të drejtë të ndërroj klubin edhe në rastet tjera të jashtëzakonshme të parapara me Vendimin e Bordit i cili nxirret së paku 15 ditë para fillimit të edicionit garues. Për kalime të tilla përpos taksës së rregullt paguhet edhe taksa shtesë në bazë të Vendimit të Bordit.

Klubi mundë të tërheq kërkesën për regjistrimin e lojtarit, 3 ditë para përfundimit të afatit kalimtar.

Lojtari mundë ta tërheq kërkesën në afatin e njëjtë vetëm me lejen e dhënë me shkrim nga ana e klubit.

## -PROCEDURA E KALIMIT-

### **Neni 9.**

Lojtari i cili dëshiron që të kaloj prej klubit në klub, duhet që të kompletoj gjithë dokumentacionin e paraparë me këtë rregullore.

Kërkesa për kalim i parashtrohet gjatë afatit kalimtar, komisionit për kalimin dhe regjistrimin e lojtarëve.

Kërkesa duhet të parashtrohet dhe evidentohet, më së largu deri në ora 16.00 të ditës së fundit të afatit kalimtar.

Në kërkesat e parashtruara, vendimin në shkallë të parë e bie komisioni për kalimin dhe regjistrimin e lojtarëve. Në vendimet e Komisionit është e lejuar ankesa në afat prej 3 ditëve, prej ditës, datës së marrjes së vendimit.

Ankesa duhet t'i drejtohet K.A. të FBK-ës. K.A. në lidhje me ankesën duhet të bie vendim për afat prej 3 ditëve, prej ditës së paraqitjes së ankesës.

## -DËMSPËRBLIMI-

### **Neni 10.**

Klubi ka të drejtë në dëmshpërblim, për lojtarin me të cilin ka të nënshkruar kontratë ose për lojtarin i cili nuk dëshiron të nënshkruaj kontratën e parë profesionale e i cili kalon prej klubit amë në klubin tjetër, para se ti mbush 18 vite.

Dëmshpërblimin në bazë të kësaj rregulloreje paguhet për lojtarët të cilët nuk dëshirojnë të nënshkruajnë kontratën e parë profesionale.

Klubi amë konsiderohet klubi nga i cili lojtari shkon para arritjes së moshës 18 vjeçare.

### **Neni 11.**

Dëmshpërblimi do të përcaktohet në bazë të pikëve. Vlerën e pikëve do ta përcaktoj Bordi i FBK-ës me vendim të posaçëm.

Pikët do të llogariten në këtë mënyrë:

- Për lojtarin i cili ka luajtur për klubin amë 1 vit-1.000 pikë,
- Për lojtarin i cili ka luajtur për klubin amë 2 vite-2.000 pikë,
- Për lojtarin i cili ka luajtur për klubin amë 3 vite-3.000 pikë,

E kështu me radhë, për çdo vit nga 1.000 pikë, më shumë.

Gjatë përcaktimit të vlerës së pikëve, Bordi do të marr parasysh kualitetin e lojtarit, në bazë të vlerësimeve të Këshillit profesional të FBK-ës.

Dëmshpërblimi nga neni 11, e paguan klubi në të cilin lojtari kalon, nëse klubet, nuk arrijnë marrëveshje për dëmshpërblim.

## -STATUSI I LOJTARIT DHE KONTRATAT-

### **Neni 12.**

Varësisht prej raportit të klubit dhe lojtarit, lojtari në klub mundë të ketë statusin e:

- Lojtarit profesionist
- Lojtarit amator dhe
- Lojtarit me burse (kontrata për aftësim sportiv).

### **Neni 13.**

Lojtarë profesionist janë lojtarët të cilët me klubin kanë të nënshkruar kontratë profesionale, me të cilën në mënyrë precize rregullohen të drejtat dhe obligimet në mes të klubit dhe lojtarit

### **Neni 14.**

Lojtar amator është lojtari i cili me aktivitete të basketbollit merret në baza amatore. Lojtarët amator nuk janë të obliguar të kenë kontratë për angazhim sportiv. Lojtarët amator nuk mund të pengohen nga klubi për kalim në klubin tjetër gjatë afateve të rregullta kalimtare.

## KONTRATA PER DHENJEN E BURSES

### **Neni 15.**

Lojtari me bursë është lojtari i cili me klubin ka kontratë për aftësim sportiv. Kontrata për aftësim sportiv duhet t'i përmbajë dispozitat e kontratës mbi bursën.

### **Neni 16.**

Kontratën duhet ta nënshkruajnë klubi (përfaqësuesi i autorizuar) dhe lojtari. Kontratën duhet ta nënshkruaj edhe prindi ose kujdestari.

Kontrata ka karakter të fshehtësisë afariste, të dhënat nga kontrata mund të i dinë vetëm organet e autorizuara të Federatës.

Kontratën për bursë (aftësim sportiv) mund ta nënshkruajnë lojtarët më të rinj se 18 vjet, deri në arritjen e moshës 18 vjeçare si dhe nxënësit dhe studentët nën moshën 23 vjeçare.

## PERMBAJTJA E KONTRATES

### **Neni 17.**

Kontrata duhet t'i përmbaj këto elemente:

- Afati i kontratës,
- Të drejtat dhe obligimet e klubit
- Të drejtat dhe obligimet e lojtarit
- Klauzolën për kompetencën e K.A. të FBK-ës.

Detalet financiare në mes të klubit dhe lojtarit rregullohen me Aneks-kontratë. Me aneks-kontratë duhet që në mënyrë precize të rregullohen të drejtat dhe obligimet financiare (vlera e kontratës, mënyra e pagesës).

Aneks-kontrata (kopja e klubit dhe e lojtarit) i dorëzohet në vulosje Sekretarit të FBK-ës ose personit tjetër të autorizuar nga Bordi, i cili duhet që kontratën ta vulos dhe nënshkruaj.

Aneks-kontrata dorëzohet në të njëjtën ditë në të cilën dorëzohet kontrata. Kontrata në mes të klubit dhe lojtarit është e plotfuqishme prej ditës prej së cilës është dorëzuar në FBK.

Në rast të shkëputjes së kontratës me marrëveshje në mes të klubit dhe lojtarit, klubi obligohet që menjëherë për një gjë të tillë, ta njoftoj komisionin për regjistrim, duke e dorëzuar një kopje të marrëveshjes.

#### **Neni 18.**

Lojtari i cili nënshkruan dy apo më shumë kontrata, dënohet me 1.000 Euro dhe mbetet anëtarë i klubit me të cilin ka të nënshkruar kontratën e parë.

### **-KONTRATA E PARË PROFESIONALE –**

#### **Neni 19.**

Klubi amë, gjegjësisht klubi në të cilin lojtari i ka mbushur 18 vite, ka të drejtë që lojtarit të i ofroj kontratën e parë profesionale.

Kontrata profesionale mund t'i ofrohet lojtarit edhe para se lojtari ti ketë mbushur 18 vite (prej moshës 15 deri 18 vjeçare).

Lojtari mund të nënshkruaj kontratën e parë profesionale me klubin amë, ose me klubin në të cilin i ka mbushur 18- vite, ose mundë ta refuzoj një gjë të tillë. Nëse lojtari nuk dëshiron ta nënshkruaj kontratën e parë profesionale, atëherë klubi ka të drejtë në dëmshpërblim në bazë të dispozitave të kësaj rregulloreje.

#### **Neni 20.**

Klubi amë i cili dëshiron të lidhë kontratën e parë profesionale me lojtarin, obligohet që lojtarit t'i ofroj kontratën më së largu deri, pesëmbëdhjetë (15) ditë para afatit të parë kalimtar në të cilin lojtari i ka mbushur 18 vite.

Nëse lojtari nga paragrafi 1 i këtij neni, refuzon ta nënshkruaj kontratën, atëherë klubi deponon kontratën e ofruar në FBK, në bazë të së cilës realizon të drejtën në dëmshpërblim në bazë të kësaj rregulloreje.

Nëse klubi amë nuk vepron, në bazë të dispozitave nga paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni, konsiderohet se nuk është i interesuar të lidh kontratën e parë profesionale me lojtarin.

#### **Neni 21.**

Kontrata e parë profesionale duhet të nënshkruhet së paku për periudhën katër vjeçare.

### **-AFATI I KONTRATËS -**

#### **Neni 22.**

Në afatin e kontratës nuk do të llogaritet:

1. Koha e kaluar nën masën disiplinore të dënimit me mos lojë në kohëzgjatje prej 6 muaj, të cilin e ka shqiptuar klubi, me kusht që të jetë i deponuar në FBK,

2. Koha e caktuar nën masën disiplinore të dënimit me mos lojë, në kohëzgjatje prej më shumë se 6 muaj të cilin e ka shqiptuar organi kompetent i FBK-ës,
3. Kohën të cilën e kalon lojtari në shtetet e jashtme pa lejen e FBK-ës,
4. Koha të cilën e kalon lojtari në botën e jashtme, në shkollim
5. Koha e kaluar në burg, nëse lojtari është dënuar me më shumë se 6 muaj burg,
6. Kohën të cilën lojtarja e kalon në pushim të lindjes.

#### -SHKËPUTJA E KONTRATËS

##### **Neni 23.**

Nëse klubi dhe lojtari, nuk i përmbushin obligimet kontraktuese, klubi dhe lojtari kanë të drejtë të kërkojnë shkëputjen e kontratës.

##### **Neni 24.**

Kërkesa duhet të parashtrohet më së largu deri 15 ditë para fillimit të afatit kalimtarë, komisionit për kalimin dhe regjistrimin e lojtarëve.

Kërkesa mundë të tërhiqet në çdo moment, gjatë zhvillimit të procedurës pranë komisionit për regjistrim dhe K.A. të FBK-ës.

##### **Neni 25.**

Komisioni për regjistrim duhet të vendos në lidhje me kërkesën, më së largu deri 3 ditë para fillimit të afatit kalimtar.

##### **Neni 26.**

Në vendimet e komisionit për regjistrim, pala e pakënaqur ka të drejtën e ankesës në K.A. të FBK-ës në afat prej 48 orëve prej datës, datës së marrjes së vendimit K.A. duhet të vendos në lidhje me ankesën në afat prej 5 ditëve prej datës së paraqitjes së ankesës.

#### -SHKËPUTJA E KONTRATËS ME MARREVESHJE-

##### **Neni 27.**

Nëse shkëputet kontrata, në mes të klubit dhe lojtarit, lojtari është i lirë që të zgjedh klubin, me të cilin do të nënshkruaj kontratën e re, me kushtet e parapara në këtë rregullore.

Shkëputja e kontratës duhet të bëhet me shkrim, në formën e paraparë me ligjin mbi marrëdhëniet e detyrimeve.

Marrëveshja për shkëputje të kontratës, duhet të deponohet në FBK, në mënyrë, që të prodhoj efekte juridike.

#### -DEPONIMI I KONTRATËS-

##### **Neni 28.**

Kontratat e nënshkruara në mes të klubeve dhe lojtarëve duhet të deponohen në FBK.

Deponimi i kontratës për lojtarët e Superligës së Kosovës, është kusht për regjistrimin dhe licencimin e tyre, për edicionin përkatës garues.

Nëse klubi dhe lojtari nuk deponojnë kontratën, deri më datën e licencimit të lojtarëve në FBK, konsiderohet se kontrata nuk ekziston.

Në kontest, për shkëputje të kontratave pranë komisionit për regjistrim dhe K.A. të FBK-ës merret parasysh aneks-kontrata e vulosur dhe e nënshkruar prej Sekretarit të FBK-ës ose personit tjetër të autorizuar nga Bordi dhe kontrata e deponuar në FBK.

#### -E DREJTA E GARIMIT –

##### **Neni 29.**

Pas regjistrimit lojtari e fiton të drejtën e licencimit. Licencimi i lojtarëve bëhet me afatet e përcaktuara nga Bordi i FBK-ës. Licencimin e lojtarëve e bënë Komisari i garave.

Me marrjen e licencës, lojtari e fiton të drejtën e garimit. Përveç regjistrimit, kusht tjetër për marrjen e licencës është kontrollimi mjekësor i lojtarit dhe marrja e vërtetimit për gjendjen e mirë shëndetësore të lojtarit.

#### -HUAZIMI I LOJTARËVE-

##### **Neni 30.**

Klubi ka të drejtë që lojtarin me të cilin ka lidhur kontratë, dhe me të cilin ka mundësi të nënshkruarit të kontratës së pare profesionale, ta huazoj në klubin tjetër.

Huazimi i lojtarëve mundë të bëhet vetëm në mënyrën e përcaktuar me Vendim nga Bordi i FBK-ës.

Paraqitja e lojtarëve për huazim bëhet në formularin përkatës, të caktuar nga Sekretari i FBK-ës.

Koha e kaluar në huazim, llogaritet në afatin e kontratës, të cilin klubi amë e ka lidhur me lojtarin.

Me skadimin e afatit të huazimit, lojtari automatikisht është lojtarë i klubit amë, nëse nuk i ka skaduar kontrata.

#### -PARAQITJA E LOJTARËVE VENDOR NË KLUBET E SHTETEVE TË HUAJA-

##### **Neni 31.**

Një lojtarë mundë të luaj, për klubet e Shteteve të huaja nëse nuk ka obligim kontraktues ndaj klubit të vendit.

Leja për t'u paraqitur dhe regjistruar në klubet e Shteteve të huaja, ipet me kërkesën e Federatës nacionale të klubit, në të cilin lojtari dëshiron të luaj ose më kërkesën tij.

Vendimi për dhënien e lejes për t'u regjistruar në klubet e Shteteve të jashtme e bie Sekretari i FBK-ës, në afat prej 3 ditëve, prej ditës së paraqitjes së kërkesës.

Nëse lojtari shkon jashtë shtetit pa pëlqimin e FBK-ës automatikisht dënohet me 6 muaj moslojë pas kthimit në klubet e FBK dhe nuk mund të luaj për përfaqësuesen e Kosovës.

## -KTHIMI I LOJTARËVE VENDOR NGA KLUBET E SHTETEVE TË HUAJA-

### **Neni 32.**

Regjistrimi i lojtarëve vendor të cilët kthehen nga klubet e Shteteve të huaja, bëhet në bazë të letrës dalëse (letter of clearance) të Federatës nacionale të klubit, për të cilin lojtari ka luajtur për herë të fundit.

### **Neni 33.**

Lojtarët e kthyer nga klubet e Shteteve të huaja, mundë të regjistrohen për klubet vendore gjatë afateve kalimtare të rregullta dhe të jashtëzakonshme të caktuara nga Bordi i FBK-ës së paku 15 ditë para fillimit të edicionit garues.

### **Neni 34.**

Lojtarët që shkojnë në botën e jashtme për motive shkollimi pa letër dalës (L.C), nëse në shkollim shkojnë më shumë se 2 vite, pas kthimit në Kosovë, kanë statusin e lojtarit të lirë, në të kundërtën lojtari duhet të kthehet në klubin prej të cilit ka shkuar në botën e jashtme.

Lojtari duhet në FBK të prezantoj vërtetimin se është regjistruar në njërin prej Shkollave në botën e jashtme.

## -REGJISTRIMI I LOJTARIT TË HUAJ-

### **Neni 35.**

Klubi imund të regjistroj basketbollistë të huaj për një edicion garues.

Numri i lejuar i lojtarëve të huaj për çdo rang garues, mënyra ,afatet dhe taksat shtesë për regjistrim dhe zëvendësim caktohen me vendim të Bordit së paku 15 ditë para fillimit të edicionit garues.

Klubi duhet të deponoj kontratën me lojtarë të huaj në FBK.

Për regjistrimin e lojtarëve të huaj gjatë afateve të rregullta kalimtare klubet duhet të paguajnë taksën prej 100 € në xhirrolligari të FBK-ës, ditën e paraqitjes së kërkesës për regjistrim.

### **Neni 36.**

Klubet e ligës së Dytë nuk kanë të drejt të regjistrojnë lojtarë të huaj, përveç Shtetasve të Huaj që punojë apo shkollohen në Kosovë.

Për regjistrimin e lojtarëve të huaj nga paragrafi 1 i këtij neni klubi duhet të sjell kontratën e punës së lojtarit me organizatën apo vërtetimin për shkollim.

Klubi mundë t'i regjistroj vetëm 2 lojtarë me status të këtyllë me afate të kalimit dhe taksa sikurse lojtarët vendor.

### **Neni 37.**

Lojtari i huaj i cili regjistrohet për një klub mund të ndërroj klubin vetëm një herë, në edicionin e njëjtte të garave, dh atë më pëlqim të klubit.

### **Neni 38.**

Lojtarit të huaj për regjistrim i nevojiten:

- Fotokopja e pasaportës,
  - Plotësimi i formularit të caktuar nga Sekretari i FBK-ës,
  - Kontrata me klubin
  - Letrën dalëse nga Federata nacionale ku ka luajtur së fundmi (pas pranimit në FIBA, deri në pranim në FIBA Deklaratën e lojtarit që nuk luan në shtet tjetër
- Kërkesa për regjistrimin e lojtarit të huaj duhet të bëhet më së largu 48 orë(dy ditë) para fillimit të ndeshjes së radhës.

### **Neni 39.**

Lojtarë të huaj në kuptimin e kësaj rregulloreje janë të gjithë lojtaret të cilët nuk i posedojnë dokumentet identifikuese të lëshuara nga UNMIK-u.

## **-FITIMI I STATUSIT TË LOJTARIT VENDOR –**

### **Neni 40.**

Lojtari i cili në Kosovë i cili në Kosovës luan së paku 3(tri)vite në kontinuitet konsiderohet lojtarë vendor.

Lojtari mund ta fitoj statusin e lojtarit vendor në afatin veror respektivisht miniafatin kalimtar ,varësisht se kur është regjistruar për herë të parë në FBK.

Dënimi i lojtarit nuk konsiderohet ndërprerje e kontinuitetit.

Lojtari i cili pas fitimit të këtij statusi me rastin e ndërprerjes së kontinuitetit të lojës e humb këtë status.

FBK mundë të lidh marrëveshje me Federatën nacionale të Shteteve të huaja, që lojtarët Shtetas të asaj Federate, të konsiderohen lojtarë vendorë.

**-DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT-**

**Neni 41.**

Kjo rregullore hynë në fuqi ditën e aprovimit të saj nga Kuvendi i FBK-ës.

Pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, pushon të vlejë Rregullorja e miratuar më 22.07.2006.

**Neni 42.**

Interpretimi i kësaj Rregulloreje e bënë Bordi i FBK-ës.

Kryetari i FBK  
Erolld Belegu